REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-SKUPŠTINA OPŠTINE MALIŠEVO
PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 13/10/2026
PRIMLJENO:
Nr. Prot: 021298

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së-I- (parë) urgjente të Kuvendit Komunal të Malishevës

Koha:30.09.2026
Ora: 14:30

Të pranishëm:Kryesues i Kuvendit Fatmir Ademaj,18 anëtarë të Asamblesë Komunale,Drejtori për zhvillim Ekonomik dhe Turizëm z.Arbër Kastrati,Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Nuredin Hoxha,Drejtori për Shërbime Publike z.Izet Hoti,Drejtori i Inspektoriatit z.Jakup Gashi,Drejtori për Ekonomi dhe Financa z.Blerim Thaçi si dhe zyrtar nga zyra e informimit znj.Agnesa Pintolli dhe z.Izet Shala.

Kryesuesi i Kuvendit e hapi dhe e udhëheqi mbledhjen e parë urgjente të Kuvendit Komunal të Malishevës.
Fatmir Ademaj(Kryesues i Kuvendit):Përshëndetje!Ju falenderojë që keni gjetur kohë me marrë pjesë në seancën e parë urgjente,para se me vazhduar me rendin e ditës,ju njoftojë se kjo seancë ka të bëjë pikërishtë për shkak që Draft,Rregullorja ka pasur dëgjim publik deri më datën e sotme me të cilën është mbajtur konsultimi publik dhe pastaj është dashur me mbajtur seancën për votimin e saj.Ne e kemi pasur dje seancën e rregullt të Asamblesë votimin për buxhet dhe për mos me humbur afati në muajin shtator që e kemi edhe për Draft,Rregullore të cilat janë rrjedhimishtë së bashku me buxhetin,ne jemi të obliguar që sot me mbajtur seancën e parë urgjente për votim.Kryesuesi e vuri në votim rendin e ditës si në vijimë:

R E N D I I D I T Ë S

1.Shqyrtim dhe miratim i Draft Rregullores për taksa,tarifa dhe ngarkesa komunale.

Rendi i ditës u miratu unanimisht nga anëtarët e Asamblesë Komunale.
Rezultati i votimit:
Për 18,kundër 0,abstenim 0.

atyre atyre që janë të ngjtitura në harmoni me murin e objektit në shumën prej 30 € kjo është një tarifë e ulët sepse ne e dim sa paguhet marketingu.

Arbër Kastrati(Drejtor për zhvillim Ekonomik dhe Turizëm):Në të kaluarën ka qenë 30 € kurse tani është 100€.

Veton Zogaj(Gp-LVV):Gjithashtu te neni 16.4 Vendosja e tavolinave shërbyese jashtë lokalit afarist në prona publike tarifa është vendosur e ulët është dashur me qenë më e lartë.Te neni 16.5 Ngarkesa ne marrjen e automjeteve ne vendet e ndaluara nga komuna është cekuar shuma prej 5 € edhe kjo do të duhej me qenë më e lartë.Në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa pata një dilëm për shumat që ishin të lartë për disa çertifikata shëndetësore nëse ato janë përcaktuar sipas udhëzimit administrativ ne nuk kemi të drejtë me ndryshuar mirëpo unë nuk jam duke i gjetur si dhe në Draft Rregullore nuk i kanë cekur nëse janë bazuar sipas udhëzimit administrativ.Nëse ne kemi të drejtë është mirë me ndryshuar te çertifikata për punësim është cekur shuma prej 15 €,kjo shumë është shumë e lartë do të ishte mirë me caktuar vlerën prej 1 ose 2 euro, Certifikata shëndetësore për punësim në vende me kushte të veçanta pune shuma prej 50 € është jashtëzakonisht e lartë,Certifikata shëndetësore për aftësitë psiko-fizike të përgjithshme dhe të veqanta shuma prej 50 €.Drejtor para se me përfunduar ndryshimet ndoshta do të ishte mirë që ju me pasur udhëzimin administrativ dhe nëse ato fare nuk janë,unë kërkoj që me i zbritur vlerat për çertifikatat shëndetësore.Faleminderit shumë.

Imran Xhyliqi(Gp-PDK):Përshëndetje për të gjithë!Në Komitetin për Politikë e Financa e diskutova pikën te Arsimi, veprimtaritë profesionale dhe mbrojtja shëndetësore, Shërbimet specialistike në ordinanca private është cekur tarifa vjetore në shumën prej 200 €,kurse Shërbimet specialistike private njëditore në javë është cekur tarifa vjetore në shumën prej 50 €.A është fjala për ato ordinanca që punojnë një herë në javë një doktor apo vjen doktori prej një shteti të huaj,paguajnë 50 €?Kurse për ordinanca specialistike private që punojnë në komunën tonë kanë mbetur 200 € edhe për vitin 2026-të.Për shembull nëse ne e bëjmë një krahasim me një biznes tjetër siq është frizerk për meshkuj,këpuctar,oratorë apo rrobaqepës të cilën logjikisht e dina që e kanë qarkullimin shumë më të vogël se sa mjekët e kanë të njejtën tarifë 200 €.Që nga vitin 2025-2026 ju ka ngritur 100€ kjo ngritja prej 100 € në qfarë kalkulimi është bërë?Unë nuk e kam të kjartë.Secila tarifë që është ngritur mbi qfarë baze është bërë?Te Shërbimet specialistike në ordinanca private në krahasim me pika e tjera për mendimin tim kjo shumë është shumë e vogël,kur ne të gjithë e dimë se një vizitë në ordinanca private kushtonë prej 30 euro e deri në 50 euro,ka raste të cilat kushtojnë edhe 100 euro.Kërkoj me na shpejguar më shumë te këto pika.Faleminderit shumë.

Fatmir Ademaj(Kryesues i Kuvendit):Ne kemi mundësi me i harmonizuar propozimet të cilat i paraqiten anëtarët e Kuvendit si për shembull ajo e z.Halilit,z.Hafirit,te propozimi i z.Vetonit të vendoset referenca e ligjit te përfshkrimi i tarifës dhe pastaj rrjedhimisht e ka bazën ligjore te

udhëzimi administrativ.Propozimi i z.Halilit ishte qe tarifa për pikën 15.1 të ulët dhe të bëhet në shumën prej 3 euro.Kush është për propozimin e z.Halilit?

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit u miratua propozimi i z.Halilit :Shfrytzimi i përkohëshëm i hapësirave publike (pishinave publike) më pak se një vit në vlerën e tarifës prej 3 €.

Rezultati i votimit:
Për 18,kundër 0,abstenim 0.

Propozimi i z.Hafirit ishte që të ulet shuma për fëmijët e punonjësve që punojnë në çerdhe,rrjedhimisht të jetë 25 euro.Kush është për?
Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit u miratua propozimi i z.Hafirit që tarifa për fëmijët e punonjësve që punojnë në çerdhe të jetë në shumën e vlerës prej 25 €?

Rezultati i votimit:
Për 18,kundër 0,abstenim 0.

Propozimi i z.Veton Zogaj ishte që tarifa për Vendosja e tavolinave shërbyese jashtë lokalit afarist në prona publike të jetë në shumën e vlerës prej 15 €?Kush është për?

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit u miratua propozimi i z.Veton Zogaj që Vendosja e tavolinave shërbyese jashtë lokalit afarist në prona publike të jetë në shumën e vlerës prej 15 €?

Rezultati i votimit:
Për 18,kundër 0,abstenim 0.

Propozimi tjetër i z.Vetonit ishte Drejtor që të përshkruhet saktë baza ligjore me të cilën janë mbështetur në tarifat të cilat i kanë caktuar.
Fatmir Ademaj(Kryesues i Kuvendit):I nderuar z.Imran Xhyliqi a keni propozime konkrrete për caktimin e ndonjë vlere?

Imran Xhyliqi(Gp-PDK):Jo,unë nuk pata ndonjë propozim konkrretë.Por kërkojë shpjegim për ngritjen e cilës që e kanë bërë.Mbi cilën bazën janë bërë?

Kryesuesi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj e vuri në votim propozimin dhe ndryshimin e Rregullores 02/31 për taksa,tarifa dhe ngarkesa komunale.
Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit Komunal u miratua

Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullorës NR.02/31,për Taksa,Tarifa dhe ngarkesa komunale.
Rezultati i votimit:
Për 18,kundër 0,abstenim 0.

Punimet e mbledhjes përfunduanë në ora:15:00.

Malishevë,Shtator
30.09.2026

Procesëmbajtsja

Fatlume Delija

Kryesus i Kuvendit

Fatmir Ademaj